



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 49-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-3559 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-3559/1 me datë 15.07.2019, dorëzuar nga parashtruesi nga,
NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-3559 nga viti 2019, për rastin e lëndës është vepruar nga organe tjera kompetente.

Lënda me numër 12-3559 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-3559 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-3559/1 me datë 15.07.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga Me denoncimin janë dërguar edhe dy shkesa me numër 12-3559/2 me datë 20.08.2019 dhe me numër 12-3559/3 me datë 26.09.2019, me të cilat parashtruesi i denoncimit bënë plotësim si dokumentacione dëshmi në lidhje me akuzat e lëndës.

Në denoncimin e dorëzuar dhe plotësimin e të njëjtës flitet për akuza për pakënaqësi nga veprimi i njësisë rajonale për procedurë administrative të shkallës së parë në, në lidhje me atë se parashtruesi i denoncimit nuk i është mundësuar të bënë vështrim në lëndën për të cilën është zhvilluar procedura në njësinë e përmendur.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parashyshë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek institucionet kompetente për informacione dhe të dhëna në lidhje me rastin e lëndës. Me kërkesë të Komisionit shtetëror janë dorëzuar lajmërimet me informacionet e kërkuara me shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës nga ana e KSHPK është vërtetuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për lëndë për të cilën është zhvilluar procedurë për privatizim të tokës ndërtimore dhe në të cilës nga ana e Ministrisë për financa, Drejtorisë për çështje juridike të pronës, Njësia rajonale për procedurë administrative të shkallës së parë në, me datë 05.11.2018 është miratur Vendim për kërkesën e dorëzuar për privatizim

të tokës ndërtimore në emër të personi tjetër fizik i cili është fqinjë i parashtruesit të denoncimit, dhe me të cilin vendim atij si fqinjë i drejtpërdrejtë i është bërë dëm dhe i është marrë një pjesë nga toka e tij ndërtimore e cila gjer më sot nuk i është paguar.

Për punën jologjore të të punësuarve në Njësinë për çështje juridike të pronës në, u drejtua me ankesë deri tek shoqëritë joqeveritare në Shkup, të cilët u interesuan për rastin dhe pastaj nga ana e tyre është kërkuar që në këtë rast në mënyrë të jashtëzakonshme të bënë inspektim nga Inspektorati shtetëror administrativ, i cili ka bërë inspektim të jashtëzakonshëm me datë 14.11.2018 dhe është përgjigjur me shkrim se gjatë inspektimit janë konstatuar parregullësi të caktuara dhe lëshime gjatë zhvillimit të procedurës administrative nga njësia për procedurë administrative të shkallës së parë, përshkak të së cilës në përputhje me nenin 17 paragrafi 1 nga Ligji për inspektim administrativ, nga Inspektorati administrativ është miratuar Vendim me datë 22.10.2018, me të cilën obligohet subjekti për mbikqyrje që t'i mënjanon parregullsitë me afat të caktuar të veprimit prej 20 ditë nga dita e pranimit të vendimit.

Parashtruesi i denoncimit, informon se Njësia për procedurë administrative të shkallës së parë asgjë nuk ka ndërmarrë, dhe as që është informuar ai për çfarëdo veprimi në atë drejtim për menjanimin e të gjitha parregullësive dhe lëshimeve të cilën i sugjeron Inspektorati shtetëror, dhe gjithashtu nuk është informuar edhe për atë se vallë inspektorati a ka kërkuar përgjegjësi nga dikush për parregullsitë e konstatuara.

Me datë 12.07.2018 ai ka marrë vendim me të cilën kërkesa e tij, që të merr kopje dhe të bënë mbikqyrje në lëndën për privatizimin e bërë të tokës ndërtimore, i është rrefuzuar si e pabazë dhe në të nuk është shënuar mbështetja ligjore për rrefuzimin, por është shënuar vetëm ajo që ai nuk ka dëshmuar se i janë rrezikuar të drejtat e tij në procedurën gjatë privatizimit nga ana e fqit të tij. Në lidhje me vendimin e përmendur nga ana e parashtruesit të denoncimit është shfrytëzuar e drejta e tij për udhëzim juridik dhe me datë 19.11.2018 nga ana e tij është dërguar ankesë për të cilën ka vepruar Komisioni shtetëror për vendimmarrje gjatë procedurës administrative dhe procedurë për marrëdhënje pune të shkallës së dytë dhe me datë 28.03.2019 ka miratuar vendim me të cilën ankesa dhe ankesa e përsëritur janë rrefuzuar si të papranueshme. Në sqarimi e vendimit nga Komisioni theksojnë se nga inspektimi në vendimin e privatizimit i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 08.04.2008 dukshëm është parë se toka është privatizuar në bazë të pronësisë paraprake të kërkuarit dhe se Komisioni nuk ka mundur të cakton lidhje të parcelës kadastrale ndërmjet pronës së parashtruesit dhe tokës ndërtimore e cila ka qenë lëndë e vendimit të plotfuqishëm sipas të cilës është miratuar vendimi i ankuar, dhe me të cilën Komisioni vërtetë nuk ka qenë kompetent të vepron. Në fund të vendimit, theksohet se nuk është paraparë e drejta për ankesë kundër vendimit për rrefuzim të kërkesës për dorëzim të vendimit të plotfuqishëm, kurse ankuarit/kërkuarit i sugjerohet që të drejtat e tij mund t'i realizon në përputhje me Ligjin për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik. Në lidhje me vendimin e miratuar është dhënë udhëzim juridik se kundër të njëjtës mund të ndritet mosmarrveshje administrative në afat prej 30 ditë nga dita e pranimit të të njëjtës.

Parashtruesi i denoncimit, thekson se nga ana e tij është vulosur edhe padi të cilën ai e ka parashtruar deri tek Gjykata administrative në Shkup, kundër vendimit të Komisionit

shtetëror për vendimmarrje në procedurë administartive dhe procedurë për marrëdhënje pune të shkallës së dytë me datë 28.03.2019.

- Në shkrimet të cilat parashtruesi i denoncimit i ka dorëzuar deri tek KSHPK, informon se e datë 30.07.2019 ka dorëzuar ankesë deri tek MPB – stacioni policor me arsyje të shqetësimit dhe malltretimit të tij dhe familjes së tij në lidhje me rastin e lëndës. Gjithashtu ai ka dorëzuar ankesë edhe deri tek Kryetari i komunë së përshkak të dyshimeve për manipulim me tatimit të pronës me pronën e vet dhe vendimet e miratuara. Gjithashtu deri tek KSHPK, parashtruesi dorëzoi vërejtje para padisë e cila i është dorëzuar nga ana e personit fizik me të cilën kërkohet që t'i jepet prona në qeverisje në sipërfqje prej 6 metra katrorë, e shënuar si sipërfaqe e kontestueshme e cila i është regjistruar si vlerë më e ulët në flet-pronsinë.
- Me datë 06.11.2020, me kërkesë të KSHPK, është dorëzuar informim nga ana e Gjykatës administrative e RMV me të cilën informjnë se është bërë kërkim i shënimeve në sistemin elektronik të AKMIS në Gjykatën administrative, me çka është vërtetuar se kundër vendimit me datë 28.03.2019 në Komisionin shtetëror për vendimmarrje për procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënje pune të shkallës së dytë, është regjistruar mosmarrveshje administrative pas padisë të parashtruar me datë 24.04.2019, me çka është formuar lëndë me numër të vulosur/2019. Për këtë lëndë me datë 03.10.2019 është marrë akt-gjykim me të cilin Vendimi i ankuar i Komisionit shtetëror anuohet, kurse në sqarimin e akt-vendimit është shënuar se duke vlerësuar ligjësinë e Vendimit të diskutueshëm, Gjykata gjeti se e njëjta ka qenë joligjore përshkak të shkeljes së rregullës për procedurën dhe se Gjykata mendon se ka pas nevojë për procedurë të përsëritur dhe vendimmarrje për lëndën, me çka organi i paditur duhet t'i ket parasyshtë të kuptuarit juridik dhe vërjetje e kësaj gjykate të dhënë në këtë akt-gjykim, t'i menjanon shkeljet e procedurës, të vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe se të merr vendim të drejtë dhe ligjor. Në fund të këtij akt-gjykimi është dhënë udhëzim juridik se kundër të njëjtës është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditë pas pranimit të të njëjtës, nëpërmjet këtij gjyqi deri në Gjykatën e lartë administrative.
- Me datë 12.11.2019 me kërkesë të KSHPK është marrë përgjigje nga Inspektorati shtetëror administrativ i cili informon se në lidhje me rastin e lëndës por me kërkersë të parashtruesit të denoncimit, në muajin tetor të viti 2018 është bërë inspektim i jashtëzakonshëm për mbikqyrje në Ministrinë e finansave – Drejtoria për çështe juridike të pronës - njësia për procedurë administrative të shkallës së parë -

Mbykqyrja është bërë nga ana inspektorit administrative, i cili tashmë dy vite është në pension, dhe në bazë të masave të ndërmarra dhe veprimeve është përgaditur Procesverbal për inspektim mbikqyrës të jashtëzakonshëm me datë 22.10.2018, kurse për menjanimin e mangësive të konstatuara gjatë zhvillimi të procedurës administrative për lëndën me datë 12.07.2018 nga ana e subjektit të mbykqyrjes, është miratuar vendim me datë 22.10.2018. Për masat e ndërmarra nga ana e inspektorit, është informuar edhe parashtruesi i kërkesës, gjegjësisht me shkrim me datë 22.10.2020.

Pas skadimit të afatit për ekzekutim, gjegjësisht veprim për vendimin e inspektorit, është bërë edhe inspektim mbykqyrës kontrollues dhe është përpiluar Procesverbal për

inspektim mbykqyrës kontrollues me datë 12.11.2018 i cili është dorëzuar deri tek organi i inspektuar me shkrim me datë 12.11.2018. Gjatë inspektimit mbikqyrës kontrollues dhe gjendjes së konstatuar faktike sipas të cilës Ministria e finansave – Njësia për procedure administrative të shkallës së parë në është konstatuar se është vepruar për Vendimin me datë 22.10.2018 të inspektorit administrative dhe është miratur akt administrativ – vendim Me datë 05.11.2018 me autorizimin e drejtorit, dhe njëherit është informuar edhe parashtruesi i kërkesës për mbikqyrje me shkrim me datë 12,11,2018.

Me të shënuarën, inspektori administrativ i Inspektoratit shtetëror administrativ në tërësi e ka realizuar dhe kjo lëndë, në përputhje me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë procedurën e inspektimit, llogaritet e përfunduar.

Në bazë të gjendjes së këtillë faktike të caktuar, KSHPK konstaton se nga ana e parashtruesit të denoncimit janë shfrytëzuar mjetet juridike të ofruara dhe në lidhje me rastin e lëndës dhe se nga ana e organeve kompetente deri tek të cilët është drejtuar kan vepruar në kuadër të komeptencave të veta gjegjësisht, në rastin e lëndës është vepruar nga ana e organi tjetër kompetent – Inspektorati shtetëror administrative dhe Gjykata administrative e RMV, të cilën kan ndërmarrë masa dhe aktivitete në kuadrë të kompetencave të veta ligjore dhe kan miratuar akte përkatëse (vendime dhe akt-gjykime) me të cilat para këtyre organeve kompetente procedura për lëndët për të cilan kanë vepruar llogariten si të përfunduara kurse parashtruesi i denoncimit është me kohë i informuar për aktivitetet nga ana e tyre. Në bazë të tërë të konstatuarës, Komision shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi
Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: J. C., këshilltarë
Miratoi: G. T. anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**